

VENDIM
Nr.209, datë 21.2.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E Z. ARBËR KURTI, NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, në zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 7 685 000 (shtatë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, për përballimin e shpenzimeve për kurimin e z. Arbër Kurti, në Poliklinikën S.Orsola-Malpighi, në Bolonja, Itali.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha